

1 E mërkurë, 9 qershor 2021

2 [Konferencë përgatitore për gjykim]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 09.31

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

7 Mirëmengjes dhe mirëserdhët në konferencën e parë për
8 përgatitjen e gjykimit.

9 Përpara se të fillojmë, dua që t'u jap fotografëve
10 mundësinë të bëjnë disa fotografi.

11 Urdhëroni, ju lutem.

12 Ju faleminderit.

13 Z. sekretar, ju lutem, paraqisni çështjen.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmengjes. Lënda numër
15 KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër Sali Mustafës.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUESGJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Përpara se t'ju kërkoj të pranishmëve që të prezantohen,
19 dua t'ju rikujtoj të gjithëve rregullat që duhet të
20 respektojnë gjatë gjithë kohës.

21 Përpara se të flisni, ndizni mikrofonin dhe kur të
22 përfundoni me të folur, fikeni mikrofonin. Flisni ngadalë dhe
23 qartë, duke qenë se kemi përkthim prej shqipes dhe serbishtes
24 dhe në këto gjuhë. Në këtë mënyrë, përkthyesit mund ta bëjnë
25 punën e tyre si duhet. Përpara se të ndërhyri, prisni pesë

1 sekonda në mënyrë që t'u lejoni përkthyesve të përfundojnë
2 fjalinë paraprake.

3 Gjithashtu, dua t'i rikujtoj palët, Mbrojtësen e
4 Viktimave, Zyrën Administrative, se disa informacione në këtë
5 çështje janë objekt i masave mbrojtëse dhe urdhrave për
6 konfidencialitet. Këtu përfshihet informacioni konfidencial që
7 është redaktuar nga ai, Aktakuza e konfirmuar në lidhje me
8 identitetin e disa individëve, data, vendndodhja dhe
9 informacion tjetër. Informacioni konfidencial nuk nxirret në
10 seancë të hapur.

11 Ju rikujtoj që të më njoftoni paraprakisht, në qoftë se
12 parashtrimet tuaja kërkojnë nxjerrjen e informacionit
13 konfidencial, në mënyrë që të kalojmë në seancë private ose të
14 mbyllur.

15 Tani, do t'ju kërkoj palëve, Mbrojtëses së Viktimave dhe
16 Zyrës Administrative që të prezantohen, do të filloj me Zyrën
17 e Prokurorit të Specializuar.

18 Urdhëroni.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju faleminderit. Mirëmëngjesi,
20 të nderuar Gjykatës. Mirëmëngjesi të gjithëve, Mbrojtjes,
21 përfaqësuesve të Zyrës Administrative dhe atyre që na ndjekin
22 nga jashtë.

23 Prokuroria sot përfaqësohet nga z. Alex Whiting,
24 zëvendësprokuror i specializuar; kolegët e mi, Filippo De
25 Minicis, Silvia D'Ascoli dhe unë Cezary Michalczuk, prokuror

1 në këtë çështje.

2 Ju faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUESGJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

4 Mbrojtja, tani radhën për prezantim e ka Mbrojtja. Urdhëroni.

5 Mikrofoloni.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju faleminderit. Mirëmëngjesi, të
7 nderuar Gjykatës, pjesëtar të Prokurorisë, Zyrës
8 Administrative dhe të tjerë të pranishëm. Unë jam Julius Von
9 Bone, kryembrojtës për z. Sali Mustafa. Jam i shoqëruar nga
10 anëtarët e ekipit tim, që janë z. Betim Shala nga Prishtina
11 dhe z. Fatmir Palaj.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Për hir të procesverbalit z. Mustafa është gjithashtu, i
15 pranishëm në sallë të gjyqit.

16 Z. Mustafa, ju rikujtoj se të gjitha të drejtat që dalin
17 nga Ligji dhe Rregullorja e Procedurës dhe e Provave që ju ka
18 lexuar Gjykatësi i Procedurës Paraprake vazhdojnë të jenë në
19 fuqi edhe përpara këtij Trupi Gjykues, këtu përfshihet edhe e
20 drejta për të qëndruar i heshtur.

21 Tani fjalën ja jap përfaqësuesve të Zyrës Administrative.
22 Urdhëroni.

23 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

24 Unë jam Ralph Roche dhe me mua këtu është administratorja,

25 Fidelma Donlon.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUESGJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

2 Faleminderit.

3 Për hir të procesverbalit, kolegët e mi në përbërje të
4 Trupit Gjyksesit janë gjykatësi Roland Dekkers, Gilbert Bitti
5 dhe Vladimir Mikula, kurse unë jam Mappie Veldt-Foglia
6 kryegjykatëse e Trupit Gjykses I.

7 Tani, do të paraqes historikun procedural në pika të
8 shkurtra.

9 Më falni, zonja Përfaqësuese e Viktimave, ju harrova. Me
10 të vërtetë më vjen shumë keq.

11 Urdhëroni.

12 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar Gjykatës.
13 Mirëmëngjes të gjithëve, përfaqësuesve të Prokurorisë, të
14 Mbrojtjes, të Zyrës Administrative.

15 Unë jam Anni Pues, jam Mbrojtëse e Viktimave sikurse e
16 shikoni, për momentin, jam këtu vetëm. Ekipi im do të formohet
17 shumë shpejt.

18 Ju faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

20 Faleminderit. Edhe një herë kërkoj ndjesë.

21 Po përsëritem, do të jap një pasqyrë të shkurtër të
22 historikut procedural për të bërë një hyrje në bazën ligjore
23 për seancën e sotme.

24 Më 5 maj 2021, kryetarja e Dhomave të Specializuara
25 caktoi Trupin Gjykses I, të përbërë nga gjykatësit që i

1 përmenda, për çështjen në fjalë pas kalimit të dosjes së
2 çështjes nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 7 maj 2021.
3 Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloj çështjen Trupit
4 Gjykues I. Nga ajo datë, Trupi Gjykues ka marrë disa vendime,
5 duke përfshirë vendimin mbi pjesëmarrjen e viktimave në
6 procedura, mbi emërimin e ekspertëve dhe mbi rishikimin e
7 paraburgimit të akuzuarit.

8 Më 20 maj, pra, Trupi Gjykues nxori vendimin për caktimin
9 e datës së kësaj konference për përgatitjen e Gjykatës më 9,
10 10 dhe 11 qershor, duke përfshirë dy seanca të mbyllura. Në
11 këtë vendim, Trupi Gjykues ju kërkojë palëve, Mbrojtëses së
12 Viktimave dhe Zyrës Administrative që të bëhen parashtrime në
13 lidhje me disa çështje, në mënyrë që të mbulohej i gjithë
14 informacioni i duhur për planifikimin e hapave të mëtejshme
15 deri në fillimin e gjykimit.

16 Më 2 qershor 2021, Trupi Gjykues mori parashtrimet që
17 kërkoi.

18 Tani, do t'ju informoj për qëllimin e seancës së sotme.
19 Sot edhe në ditët në vijim, jemi mbledhur në atë që quhet, si
20 mbas Rregullores, konferencë për përgatitjen e gjykimit. Këto
21 seanca kanë për qëllim diskutimin e të gjithave çështjeve që
22 duhet të zgjidhen përpara fillimit të gjykimit me palët,
23 domethënë, me ZPS-në, Mbrojtjen dhe përfaqësuesin e viktimave
24 dhe njësitë e Zyrës Administrative. Prandaj sot, nuk do
25 diskutojmë fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit dhe nuk do

1 të shqyrtojmë provat.

2 Nesër, do të mbajmë seanca të mbyllura *ex-parte* me ZPS-në
3 dhe me Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve dhe
4 një përfaqësues tjetër të Zyrës Administrative dhe pastaj dhe
5 një seancë të mbyllur *ex-parte* vetëm me ZPS-në.

6 Agjenda për ditën e sotme është si vijon: së pari, Trupi
7 Gjykues do të kalojnë listën e pikave të paraqitura në
8 vendimin e vet; e dyta, palëve do t'u jepet mundësia që të
9 ngrenë çështje tjera, në qoftë se është e nevojshme; dhe në
10 fund, do t'ju informoj për vendimet që Trupi Gjykues ka
11 ndërmend të nxjerrë në periudhën që vjen.

12 Për planifikimin afatshkurtër, kam ndërmend që të
13 vazhdojmë seancën sot deri në orën 11:00, pastaj do të kemi
14 një pushim prej gjysëm ore deri në 11:30 dhe pastaj do të
15 vazhdojmë me një seancë tjetër prej një ore e gjysëm do të
16 shohim ku do të mbërrijmë, në qoftë se ka nevojë të vazhdojmë,
17 atëherë, do të bëjmë përsëri pushim dhe do të vazhdojmë.

18 Kështu e kam planin për ecurinë e seancës sotme. E shikojë që
19 të gjithë pohojnë me kokë. Në rregull?

20 Përpara se të fillojmë me pikën 1, ju kërkoj që për një
21 ecuri efikase të seancës së sotme t'i përmbaheni pikave të
22 rendit të ditës për seancën e sotme, të mos përsërisni atë që
23 tashmë e keni thënë nëpër parashtrimet e juaja.

24 Atëherë, do të fillojmë me pikën A, hetimet dhe nxjerrja
25 e provave materiale.

1 Trupi Gjykses ka kërkuar parashtrimet e Dhomës së
2 Prokurorit Specializuar për këto dy pika: konfirmimin se
3 hetimet dhe nxjerrja e provave materiale inkriminuese kanë
4 përfunduar; dhe, pika e dytë, në lidhje me provat shfajësuese.

5 Tani, Trupi Gjykses do të dëgjojë nga Prokuroria në qoftë
6 se ka parashtrime shtesë në lidhje me këto pika.

7 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju faleminderit, e nderuar
8 Gjykatëse. Unë do të flas për këtë pikë të parë në lidhje me
9 nxjerrjen e provave materiale. Sikurse thatë, nuk do të
10 përsëritëm, do të shtoj disa të dhëna të reja që kanë dalë nga
11 java e shkuar.

12 Kemi përmendur faktin se, po përgatisim një kërkesë për
13 Trupin Gjykses për të shtuar disa prova në listën e provave
14 materiale dhe kemi përmendur gjithashtu, dy intervista shtesë
15 që kemi bërë me dëshmitarë të Prokurorisë.

16 Në fund të javës së kaluar, është bërë edhe një shtesë e
17 mëtejshme, një intervistë me dëshmitar është shtuar, që do të
18 ketë për pasojë shtimin e një dëshmitari në listën e
19 dëshmitarëve të Prokurorisë. Ne, këtë kërkesë do ta bëjmë së
20 bashku me disa kërkesa të tjera, pra, kërkesa për shtimin e
21 disa -- përfshirjen e disa provave materiale në listën e
22 provave materiale dhe për përfshirjen e këtij dëshmitari në
23 listën e dëshmitarëve.

24 Ky informacion, gjithashtu, mund të jepet edhe në seancën
25 *ex-parte* që do ta kemi më pas.

1 Një pikë tjetër që kemi ngritur në parashtrimet me shkrim
2 është se, përkthimet në anglisht dhe në shqip të njërës nga dy
3 intervistat që kemi përmendur, janë përfunduar transkriptet e
4 intervistës së dytë, në anglisht dhe në shqip po kryhen për
5 momentin, mirëpo, sikurse e thamë, presim që këto të jenë të
6 përfunduara më së voni me 21 qershor.

7 Sikurse kemi thënë në parashtrimet tona me shkrim për
8 shkak të materialeve shtesë sipas të rregullit 102(3) të
9 Rregullores, ne kemi bërë të ditur, se Prokuroria do të
10 parashtrojë një njoftim të përgjithësuar sipas rregullës
11 102(3) deri më 9 qershor 2021. Këtë nuk e kemi bërë por do ta
12 bëjmë deri në fund të kësaj jave apo në fillim të javës
13 tjetër. Nuk e kemi bërë këtë për shkak të disa aktiviteteve
14 shtesë që kanë dalë javën e kaluar.

15 Përsëri, në qoftë se Mbrojtja kërkon informacion, ne mund
16 ta njoftojmë se asnjëra nga rrobat që do të shtojmë nuk kanë
17 nevojë për redaktime.

18 Këto janë informacione shtesa që desha t'ju paraqes. Në
19 qoftë se keni pyetje të tjera, ne jemi të gatshëm që t'ju
20 informojmë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
22 Faleminderit. Mesa ju kuptova, ju e kishit fjalën për
23 transkriptin në shqip dhe në serbisht. Ju thatë që këto
24 transkripte janë përfunduar. Për cilën intervistë e kishit
25 fjalën?

1 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po, e kisha fjalën për
2 transkriptet në shqip dhe në anglisht të intervistës së
3 dëshmitarit 1679.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
5 Faleminderit, zonja prokurore.

6 Tani i drejtohem mbrojtësit. Mbrojtës e keni fjalën në
7 qoftë se keni ndonjë koment në lidhje me parashtrimet që bëri
8 Prokuroria.

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju faleminderit, e nderuar
10 Gjykatëse, në pika të shkurtra do të them disa fjalë për atë
11 që nuk e kemi përmend në parashtrimet tona me shkrim. Presim
12 që në muajin që vjen, të parashtrojmë dhe të nxjerrim material
13 shtesë. Misioni i planifikuar pritet të fillojë diku në javën
14 tjetër dhe diku nga fundi i qershorit duhet të nxjerrim pjesën
15 e parë të materialit dhe nga fundi i korrikut pjesën e dytë.
16 Pjesa tjetër e materialit që do të mbetet, do të bëhet më
17 vonë.

18 Kaq për informacion të përditësuar, të tjera pika mbeten
19 të njëjta. I kemi ndarë detyrat me bashkëmbrojtësin, përpiqemi
20 që të punojmë në mënyrë sa më efikase për sa i përket
21 nxjerrjes së materialeve dhe parashtrimeve.

22 Ju faleminderit s'kemi gjë tjetër për të shtuar.
23 Faleminderit.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Kam
25 edhe disa pyetje. E para, a keni diçka për të thënë lidhur me

1 atë që tha prokurorja tash?

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, nuk kemi
3 diçka për të thënë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Në
5 lidhje me pyetjen që ju kemi bërë juve në vendimin tonë, a
6 mund të na thoni, ju lutem, diçka më shumë për natyrën e
7 hetimeve tuaja që do të bëni gjatë dy-tre muajve të ardhshme.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Natyra e tyre do të jetë që ne do
9 të bëjmë hulumtime në disa materiale të tjera, do
10 intervistojmë një numër personash dhe programi ynë do të varet
11 edhe nga disponueshmëria e personave që do të intervistojmë,
12 por të themi këtë, që do të punojmë gjatë gjithë kohës së
13 pushimit të verës dhe besojmë që misioni ynë i fundit do të
14 jetë në javën e parë të gushtit.

15 Dhe besoj, që deri atëherë do t'i kemi përfunduar hetimet
16 tona. Do kemi përcaktuar si datë të fundit 15 gushtin por
17 besoj që do të jemi gati edhe më herët. Por pak a shumë do të
18 jetë data pas përfundimit të pushimit të Gjykatës, pushimit të
19 verës së Gjykatës.

20 Sigurisht, jo gjithmonë njerëzit janë të disponueshëm apo
21 kanë kohë kur i duam ne për t'u intervistuar. Disa prej tyre
22 mund të mos jenë në Kosovë dhe prandaj, ndoshta do të na duhet
23 pak më tepër kohë. Por pak a shumë këto janë afatet që i kemi
24 përcaktuar vetes.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] I keni

1 planifikuar udhëtimet apo jo?

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, mund t'ju them udhëtimet
3 tona; së pari, udhëtimi i parë është bashkëmbrojtësi, kolegu
4 im këtu. Udhëtimi im tjetër është javën tjetër, të mërkurën
5 ndoshta. Do të qëndroj aty tetë-nëntë ditë dhe pastaj, ne
6 mendojmë që do të dorëzojmë materiale për protokollim.

7 Pastaj, në korrik do të -- në javën e dytë dhe të tretë
8 do të kemi një mision tjetër dhe udhëtimi i fundit është
9 parashikuar për në fillim të gushtit, java e parë e gushtit.
10 Pra, udhëtimi i dytë në korrik dhe, pastaj tjetri në javën e
11 parë të gushtit. Materialet që do të mbledhim nga ato
12 udhëtime, dëshirojmë që t'i nxjerrim në fund të periudhës,
13 pra, në fund të tre udhëtimeve, të tre misioneve. Pra, ndoshta
14 do të jetë në datën -- mbas datës 15 gusht. Por deri atëherë
15 besoj që do të kemi përfunduar hetimet tona.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit për këtë.

18 Kam edhe një pyetje shtesë.

19 Pse nuk u kryen këto hetime gjatë kohës së procedurës
20 paraprake? Ndoshta ka pasur arsye shumë të rëndësishme, mund
21 të na i thoni, sepse unë mendova që këto hetimet tuaja kishin
22 përfunduar gjatë periudhës paraprake por kur po lexoja
23 dokumentet e pashë që nuk kishin përfunduar.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, unë kam bërë
25 një seancë *ex-parte* me Gjykatësin e Procedurës Paraprake dhe

1 gjatë asaj seance fola për një numër çështjes dhe problemesh
2 që kam pasur dhe ato ishin arsytet se pse u vonua procesi, u
3 vonuan hetimet. Pa dashur që t'i përmend çështjet që u
4 përmendën në atë seancë *ex-parte*, aty janë dhënë të gjitha
5 arsytet se pse u vonuan hetimet.

6 Nuk dua të hy në këtë çështje tani, por besoj që çdo gjë
7 u tha aty në seancën *ex-parte* dhe ato ishin arsytet pse patëm
8 vonesa.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Në
10 rregull.

11 Këto ishin pyetjet për momentin për ju nga Trupi Gjykses
12 në lidhje me këtë pikë.

13 Zonja prokurore dëshironi të komentoni për çështjet që
14 ngriti avokati mbrojtës në lidhje me hetimet?

15 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, e nderuar Gjykatëse nuk kam
16 asgjë më tej.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
18 Atëhere do të kalojmë tek pika tjetër që është vizitat në
19 vendndodhje. Prokuroria, Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtësi i
20 të akuzuarit kanë dhënë mendimet e tyre. Ndërkohë që
21 Prokuroria dhe avokati mbrojtës shprehin dyshime për sa i
22 përket dobishmërisë së vizitës në vendndodhje, Mbrojtësja e
23 Viktimave është në favor të kësaj.

24 A ka ndonjë që do dëshiron të japi mendime të mëtejshme
25 në lidhje me këtë pikë?

1 Zoti prokuror, keni fjalën.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Vetëm për të theksuar një pikë
3 që, nëse vendoset se është e nevojshme, që të bëhet vizitë në
4 vendndodhje dhe nëse Trupi Gjykses mendon se kjo do ta
5 ndihmojë Trupin Gjykses të krijojë mendimin e vet për
6 çështjen, për vendndodhjen, për gjeografinë e vendit ne do të
7 propozonim që kjo të bëhet mbasi Prokuroria dhe Mbrojtja të
8 kenë paraqitur argumentet e tyre.

9 Pra, arsyeja për këtë është që Gjykata të ketë një ide të
10 qartë dhe një kuptim të qartë të çështjes dhe, pastaj, të
11 bëhet kjo vizitë, që të kuptojnë gjykatësit se ku ishin këto
12 ndërtesa në prill të vitit 1999. Sepse faktikisht atje tani
13 nuk ka asgjë që mund të shihet dhe prandaj është e rëndësishme
14 që ju të kuptoni bazat e çështjes dhe pastaj të shkoni atje
15 për vizitë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
17 Mbrojtësja e Viktimave keni fjalën.

18 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

19 Unë e kam shprehur tashmë që jam në favor të një vizite
20 në vendndodhje. Dhe e mirëpres propozimin e prokurorit që kjo
21 të bëhet mbasi të ketë mbaruar parashtrimi i argumenteve nga
22 Prokuroria.

23 Mendoj që është mirë të vizualizohet se ku ndodhen
24 ngjarjet, të shikohet sa ftohtë, sa ngrohtë dhe sa errët ka
25 qenë, si mund të jenë ndjerë personat që kanë qenë aty, sa të

1 lënduar mund të kenë qenë nga trupi dhe nga shpirti,
2 domethënë, të gjitha ato që janë të parashtruara në Aktakuzë.
3 Kjo është e rëndësishme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe
4 fajësinë në lidhje me atë që duhet të vendosi Trupi Gjykses.

5 Pra, mendoj që kjo është e rëndësishme dhe është
6 gjithashtu, e rëndësishme, që të mos jenë vetëm palët ato që
7 kanë një imazh në mendjen e tyre si është ai vend por
8 gjithashtu edhe nga ana procedurale duhet të krijojmë një
9 pikëpamje adversarjale për të parë se, domethënë, si kanë qenë
10 dhe si mund ndërtohet ky imazh.

11 Prandaj, edhe unë jam në favor të kësaj vizite.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Ne nuk mendojmë që ka ndonjë gjë
15 për të parë atje, në vendngjarjen e krimit apo vendndodhjen e
16 krimit apo të pretenduar të -- vendndodhjen e pretenduar të
17 krimit.

18 Prokuroria edhe Mbrojtja kanë dhënë shumë materiale,
19 besoj, për të parë sesi ka qenë ai vend në atë kohë.

20 Dhe, në qoftë se do të bëhet vizitë atje nuk ka asgjë për
21 të parë. Madje, është vetëm një ndërtesë e vogël që është aty,
22 një ndërtesë e parëndësishme për sa i përket Aktakuzës. Dhe,
23 megjithatë, në qoftë se shkojmë do ta shikojmë atë
24 vendndodhje, mund ta shikojmë edhe me video në tre dimensione
25 metër për metër. Kemi fotografi të tyre, i ka fotografitë edhe

1 Prokuroria nga të gjitha këndet e mundshme, prandaj, mendoj që
2 jemi më se të përgatitur, për të përgatitur dhe të filluar
3 gjykimin pa pasur nevojë për një vizitë të tillë.

4 Në qoftë se Mbrojtësja e Viktimave dëshiron që ta
5 vizitojë vendndodhjen, atëherë, ajo është e mirëpritur që të
6 shkojë atje ta shikojë vetë, ashtu siç ka bërë Mbrojtja dhe
7 Prokuroria. Po unë nuk mendoj që ka ndonjë çështje që ka
8 mbetur pa diskutuar apo që nuk është vënë re apo shënuar në
9 lidhje me të. Mendoj edhe një herë, që edhe Prokuroria edhe
10 Mbrojtja kanë dhënë material të bollshëm në lidhje me këtë.

11 Pra, pak a shumë kjo është pikëpamja jonë edhe këtë e
12 kemi parashtruar dhe me shkrim. Në qoftë se do të bëhet ndonjë
13 vizitë, pavarësisht nga çështjet logjistike sesi do të kryhet
14 ajo vizitë, mendoj që kjo vizitë duhet të bëhet përpara sesa
15 të thirren dëshmitarët për të dhënë dëshmi. Në mënyrë që në
16 qoftë se dëshmitari do të flasë për atë hapësirë për atë vend
17 të jetë e qartë se ku është.

18 Unë mendoj, ne si Mbrojtje mendojmë, që në qoftë se e
19 bëjmë këtë në fund të paraqitjes së çështjes nga Prokuroria,
20 kjo nuk është e dobishme. Në atëkohë, në fakt, në qoftë se ja
21 propozojmë dëshmitarit apo e kundërshtojmë dëshmitarin apo
22 flasim me një dëshmitar në lidhje me një çështje që mund të
23 ketë ndodhur atje, është më mirë që vizita të jetë bërë më
24 përpara në mënyrë që mund të vizualizohet paraprakisht.

25 Pra, mendoj që duhet të bëhet vizita përpara sesa të

1 filloj dëgjimi i dëshmitarëve. Dhe ne i qëndrojmë kësaj
2 pikëpamjeje dhe nuk kam ndonjë gjë tjetër për të shtuar.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
4 Faleminderit, i nderuar avokat mbrojtës.

5 Atëherë e mbyll këtë pikë. Megjithatë, desha t'i kthehem
6 pikës A në lidhje me kërkesën për një dëshmitar shtesë. Në
7 lidhje me këtë desha të di.

8 Do të kërkonti masa mbrojtëse për këtë dëshmitar?

9 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, nuk do të kërkojmë masa
10 mbrojtëse për këtë dëshmitar.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
12 Faleminderit, në rregull.

13 Atëherë të kalojmë tek pika C, zhvillimi i procesit
14 gjyqësor. Këtu janë shtatë pika dhe do të kalohen një nga një
15 sipas radhës.

16 Pika e parë, fillimi i gjyqimit dhe deklaratat hyrëse.
17 Trupi Gjyqësor ka marrë parashtrimet nga palët dhe nga
18 Mbrojtësja e Viktimave në lidhje me datën tentative me
19 fillimin e gjyqimit për sa i përket deklaratave hyrëse, rendit
20 dhe momentit kur do të bëhen deklaratat hyrëse, kohëzgjatja e
21 tyre, nëse do të përdoren mjete vizuale.

22 Ne kemi shënuar informacionin që lidhet me këtë dhe duam
23 t'ju japim fjalën, të diskutoni për këtë.

24 Prokurori.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ne këtë e kemi diskutuar në

1 parashtrimin tonë, por desha ta them për publikun, Prokuroria
2 kërkon që gjyqi të filloj në korrik. Ne kemi dhënë një datë si
3 12 korriku i këtij viti, sipas rregullit 124 dhe 125 të
4 Rregullores, atë ditë mund të bëhet parashtrimi ose deklarata
5 hyrëse e prokurorisë dhe pastaj, Prokuroria mund të fillojë me
6 thirrjen e dëshmitarëve dhe marrjen e dëshmive më datë 15
7 korriku.

8 Prokuroria planifikon që të marrë në pyetje dy dëshmitarë
9 të saj para sesa të fillojë pushimi veror i gjykatës dhe
10 pastaj të tjerët do të bëhen pas pushimit dhe në shtator.

11 Megjithatë, në qoftë se ju, të nderuar Gjykatës, vendosni
12 datë tjetër për fillimin e gjykimit apo që marrja në pyetje e
13 dëshmitarëve duhet të fillojë në shtator, atëherë do të
14 kërkonim që deklarata hyrëse dhe dëshmitarët e prokurorisë të
15 bëhen nga shtatori. Pra, në qoftë se nuk bëhen dot në datat që
16 dhamë, atëherë mirë është të fillojë në shtator.

17 Ne nuk duam që t'i ndajmë argumentet tona hyrëse nga
18 provat dhe nga dëshmitë që do të marrim dhe në qoftë se është
19 e nevojshme, të nderuar Gjykatës, unë do të jap arsyet pse për
20 këtë gjatë seancës nesër.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Po.
22 Faleminderit.

23 Mbrojtësja e Viktimave.

24 ZNJ. PUES: [Përkthim] Siç e thashë edhe më herët, nga
25 pikëpamja e viktimave është më mirë që të fillohet pas

1 pushimit të verës.

2 Dua të shtoj se, sigurisht, viktimat duan që të bëhet
3 drejtësia. Ata kanë pritur 22 vjet dhe mirë është të fillohet
4 me këtë çështje me një përgatitje sa më të mirë dhe të
5 gjithanshme. Dhe kjo është në interes të të gjithëve dhe në
6 interes të drejtësisë së proceduarve.

7 Nga ana tjetër, për mua është e rëndësishme që të shkoj
8 në mision, po kjo nuk varet vetëm nga unë sepse unë mund të
9 prenotoj dhe të shkoj por ka -- duhet të bëhen organizime
10 mjaft të ndërlikuara dhe është një makineri e tërë në sfond e
11 cila duhet të vihet në punë.

12 Unë duhet që të jem në gjendje që të përfaqësoj
13 plotësisht dhe në mënyrë të gjithanshme -- të viktimave që
14 përfaqësoj dhe kam njerëz me të cilët duhet të flas. Kam një
15 grup të tërë njerëzish të cilët duhet të përfaqësoj.

16 Dhe, prandaj, që unë mund të bëjë një deklaratë hyrëse sa
17 më të plotë, duhet të kem kohë për tu përgatitur.

18 Po kështu, dua të them, që avantazhi i fillimit pas
19 pushimit të verës është që në atë mënyrë ne të gjithë do të
20 jemi të përgatitur plotësisht dhe mund të fillojmë me
21 procedurën ashtu siç duhet, në vend që të bëjmë një pjesë të
22 vogël të gjyqimit të fillohet përpara verës, pushimit të verës
23 dhe pastaj të bëhen procedurat e gjata pas tij.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

25 Faleminderit për këtë. Mbrojtësja e Viktimave për deklaratën

1 tuaj hyrëse, kur keni ndërmend ta paraqisni atë?

2 ZNJ. PUES: [Përkthim] Sigurisht kjo do të varet nga koha
3 se kur do të fillojmë. Në qoftë se Trupi Gjykues vendos që të
4 fillojmë në korrik atëherë, unë do të përmbush ato afate.
5 Megjithëse kam shumë të panjohura ende, ende, por unë me
6 kënaqësi do ta bëja parashtrimin apo deklaratën time hyrëse në
7 fillim të gjykimit, pasi të ketë bërë Prokuroria deklaratën e
8 vet hyrëse.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit për këtë.

11 Tani, t'i kthehem Mbrojtjes. E njëjta pyetje edhe për ju
12 dhe përveç kësaj ju jap fjalën, megjithëse, ju e komentuat
13 këtë më parë nëse i akuzuari dëshiron të bëjë një deklaratë në
14 bazë të rregullës 142 pika 1 të rregullores.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar.

16 Ne do bëjmë një deklaratë hapëse, e cila besoj që do jetë
17 goxha e gjatë por, siç e thashë edhe më parë, pra, mund të
18 ekzistojë mundësia që, edhe i akuzuari vetë mund ta bëjë një
19 deklaratë të tillë. Kështu që, domethënë, nuk është se do
20 flasim për shtatë orë, domethënë, kjo është fjala juaj hapëse
21 po është e vërtetë kjo gjë, megjithatë nuk është se synoj që
22 të flas në fjalime shumë, shumë të gjata.

23 Atëherë, unë e ndjek prokurorinë në faktin që ata thanë
24 që duan që së pari të kenë deklaratën e hapjes dhe pastaj
25 thonë që më pas mund të vijojmë me dëshmitarët. Kjo diçka e

1 kuptueshme nga ana e tyre.

2 Megjithatë, ne nuk jemi dakord me afatin kohor. Mendojmë
3 që njoftimi është shumë i shkurtër dhe ne në fakt kemi
4 planifikuar disa misione gjatë kësaj periudhe, kështu që, do
5 të na bëhej shumë e komplikuar puna në qoftë se do të duhej që
6 ta ndërprisnim atë çfarë kemi planifikuar fillimisht.

7 Kështu që, për këtë arsye nuk duam që të fillojmë
8 procesin gjyqësor në datën e propozuar nga Prokuroria, po pas
9 pushimit të verës së Dhomave të Specializuara.

10 Kështu që, do të ishte më mirë, besoj, edhe për gjykimin
11 në mënyrë që të kemi një proces të vijueshëm në vend që të
12 kemi një fragment njëherë dhe bëjmë pushimin e gjykatës dhe
13 pastaj të vijojmë sërish. Kështu që, mendoj që do ishte më
14 mirë që të vijonim sa më shumë të ishte e mundur pa u
15 ndërprerë nga ana tjetër viktimat duhet që të përgatiten,
16 Mbrojtja duhet të përgatiten ka gjëra të tjera që do të duhen
17 të bëhen, kështu që, ka edhe detaje të tjera që duhen të
18 merren parasysh përpara se ne mund të fillojmë me procesin
19 gjyqësor.

20 Mendoj, se pas pushimit të gjykatës, të gjitha këto gjëra
21 do të jenë në një vend më të mirë dhe të paktën flas për
22 familjarizimin, flas për aspektet e logjistikës sa i takon
23 dëshmitarëve, kështu që, besoj se do ishte më mirë që të
24 fillonim pas pushimit. E sepse në të kundërtën, besoj, që do
25 të ishte e pamundur që ne mund të fillonim, të ishim gati për

1 të filluar me 12 korrik.

2 Sepse nxjerrja e materialeve duhet të fillojë javën që
3 vjen. Kështu që, nuk besoj që data 12 korrik është datë
4 realiste. Kështu që, edhe njëherë, do të doja të thosha që do
5 të ishte mirë që procesin e gjykimit të mund ta fillonim pas
6 pushimit të verës të Gjykatës.

7 Ndonjë gjë tjetër lidhur me këtë çështje? Jo, nuk është
8 se kam ndonjë tjetër, besoj që i kam trajtuar të gjitha
9 çështjet.

10 Faleminderit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

12 Faleminderit, e nderuar Mbrojtje.

13 Paneli i Gjykimit do të nxjerrë një vendim lidhur me këtë
14 çështje në kohën e përshtatshme.

15 Tani le të kalojmë me pikën tjetër, që ka të bëjë me
16 familjarizimin e dëshmitarëve përpara dhënies së dëshmisë së
17 tyre. I kemi marrë parashtrimet e palëve. [Ju] faleminderit
18 për parashtrimet. Ndërkohë që Trupi Gjykses ka vënë re që
19 propozimi nga ZPS-ja për protokollin e familjarizimit dhe që
20 në këtë protokoll palët, këshilltari apo avokati i viktimave
21 dhe Mbrojtja të mund të konsultohen dhe po ashtu, të mund të
22 parashtrojnë bashkërisht parashtrime, për aq sa është e
23 mundur, në kuadër të këtij protokolli.

24 Trupi Gjykses tani do të dojë që t'ju ftojë të komentoni,
25 përveç parashtrimeve që keni depozituar me shkrim, në veçanti,

1 do të donte t'i jepte fjalën Mbrojtjes dhe avokatit të
2 viktimave për këtë propozim të ZPS-së.

3 Fjala për ju prokuror.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
5 Gjykatëse.

6 Neve i kemi listuar pozicionet tona në detaje, mendoj, në
7 parashtrimin që ju kemi depozituar. Megjithatë, në qoftë se ju
8 keni ndonjë pyetje specifike për sqarim të pozicionit tonë do
9 të isha i lumtur që t'i merrja dhe t'i përgjigjesha pyetjeve
10 të tilla. Në qoftë se nuk keni pyetje, do të doja të them që
11 ky është propozimi ynë, është propozim i plotë dhe do të jemi
12 të lumtur që të angazhohemi, të përfshihemi me Zyrën e
13 Administrimit, me palët e tjera në mënyrë që të mund të
14 realizojmë parametrat e një protokolli të tillë si sa i takon
15 familjarizimit të dëshmitarëve, po gjithashtu, edhe mënyrën
16 sesi mund të vijojmë me rishikimin e deklaratave paraprake të
17 viktimave.

18 Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

20 Faleminderit, z. Prokuror.

21 Mbrojtja për Viktimat fjala për ju.

22 ZNJ. PUES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, sipas mendimit
23 tim, do të doja të thoja që e mirëpres propozimin e
24 Prokurorisë edhe në fakt, mund të na duhej që të ndërlihem
25 rast pas rast në varësi të dëshmitarëve. Sigurisht, që unë

1 mund të flas vetëm për ata të cilët kanë status të dyfishtë si
2 dëshmitarë dhe si viktima, sepse ata janë personat që unë
3 përfaqësoj në këtë proces gjyqësor.

4 Për mua, është absolutisht shumë e rëndësishme që ne të
5 bëjmë çfarëdolloj gjëje të mundemi që të familjarizojmë dhe të
6 prezantojmë viktimat me Gjykatën në një mënyrë të tillë që të
7 jetë sa më humane dhe sa më e respektueshme që të jetë e
8 mundur, sepse, pa diskutim, që ky është një organizim goxha
9 impresionues dhe mendoj, në qoftë se, të gjitha palët do të
10 bashkëpunojnë mund ta bëjnë këtë punë shumë mirë.

11 Për momentin nuk ka komente të tjera.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Tani më lejoni t'i jap fjalën Mbrojtjes. Fjala për ju.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, e nderuar.

16 Në fakt, ne dje organizuam një takim me Zyrën e
17 Prokurorisë dhe një ndër temat që diskutuam ishte dhe kjo
18 temë. Ne do të angazhohemi në protokolle apo procese të tjera
19 të lidhur me këtë temë.

20 Dhe mendoj, që më veçanërisht, është e dobishme, siç të
21 paktën ka qenë praktika në Gjykatën Ndërkombëtare Penale, që
22 neve të marrim një raport nga WPPD-ja, domethënë, ideja është
23 që duhet të marrim një deklaratë, në qoftë se personi është në
24 gjendje që të dëshmojë, është i aftë për të dëshmuar dhe duhet
25 që ta kemi dhe këtë gjë parasysh.

1 Ndërkohë, që sa i takon pra, ndihmës në Gjykatë ose në
2 arsyet e Gjykatës edhe kjo do të duhet që të merret parasysh
3 dhe çdo gjë duhet shkoj pa probleme.

4 Megjithatë, në përvojën time kam pasur raste, kur
5 dëshmitarët mund të bëhen të komplikuar dhe këto komplikime do
6 [të] duhet që të raportohen. Dhe në asnjë rast Gjykata nuk
7 duhet të mbahet peng nga një dëshmitar i caktuar sepse personi
8 ka kërkesa të caktuara. Dhe, në fakt, e kam parë nga përvoja
9 ime e mëparshme që njerëzit përfitojnë nga rasti, kërkojnë
10 azil nga Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e dëshmitarëve dhe
11 nga ana tjetër situata duhet të jetë që dëshmitari duhet të
12 jetë thjeshtë dëshmitar.

13 Pra, thjeshtë dua të them, që duhet që të sigurohemi që
14 jemi alert për të gjitha gjërat dhe kështu që besoj, që
15 prandaj është e dobishme që të kemi një lloj raporti ose
16 raportimi ndaj palëve dhe mbi të gjitha, mendoj, që do të
17 ishte mirë që të mos kishte çështje specifike që kanë të bëjnë
18 me dëshmitarët, me kërkesat e tyre apo me nevojat e tyre, në
19 veçanti me nevojat e tyre, sepse një gjë e tillë mund të
20 cenonte mund të dëmtonte dëshminë e dëshmitarit përkatës.

21 Sepse të gjithë ne, në fund të ditës, jemi të interesuar
22 që, në qoftë se, domethënë, dëshmitari është në Gjykatë ose
23 bën deklaratë përmes videolinkut është e rëndësishëm që të
24 japë informacion të saktë dhe të drejtë.

25 Pra, besoj, që është e dobishme se duhet të ketë një lloj

1 protokolli familjarizimi dhe mendoj, që të raportohet më pas
2 për palët që çdo gjë ka shkuar siç duhet, vijojmë më tej dhe
3 që nuk ka probleme.

4 Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

6 Faleminderit, Mbrojtja.

7 Tani do të doja që të kalohej tek pika 3. Pika 3 ka të
8 bëjë me dëshmitarët dhe viktimat që kanë status të dyfishtë.
9 ZPS-ja dhe Mbrojtja për Viktimat janë pyetur në qoftë se ata
10 kanë shkëmbyer informacione sa i takon Zyrës për Mbrojtjen dhe
11 Mbështetjen e Dëshmitarëve lidhur me identifikimin e viktimave
12 pjesëmarrëse të cilat janë po ashtu dëshmitarë të ZPS-së.

13 Sipas parashtrimeve, të cilat janë depozituar në mënyrë
14 të kënaqshme, e kuptoj, që pavarësisht këtyre parashikimeve,
15 Trupi Gjykses është i interesuar që të dijë se cili është
16 rezultati i këtyre shkëmbimeve ndërmjet palëve.

17 Më lejoni t'i jap fjalën Prokurorisë për këtë çështje.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit e nderuar.

19 Është e vërtetë që ne jemi përfshirë me Mbrojtjen e
20 Viktimave në diskutime paraprake sa i takon statusit të
21 dyfishtë të dëshmitarëve si viktimat. Dua që të përfitoj nga
22 rasti që t'i referohem njëherë prej çështjeve që ne kemi
23 ngritur pak më parë lidhur me lidhjen -- me nisjen e procesit
24 gjyqësor.

25 Dhe më lejoni të them, që ne bëjmë më të mirën tonë të

1 mundshme për të lehtësuar këto kontakte brenda zyrës tonë,
2 mundësisht, edhe përpara datës që kemi përmendur, domethënë,
3 përpara qershorit, korrikut. Nuk dua të futem në detaje për
4 datat sepse flasim, gjithashtu, edhe për aspekte sigurie kur
5 flitet për kontaktimin e këtyre personave. Pjesa më e madhe e
6 tyre janë në Kosovë dhe nuk duam që t'i vendosim në rrezik të
7 panevojshëm. Por pa diskutim, neve do ta ndihmojmë Mbrojtjen
8 për viktimat me kontaktet e këtyre personave. Faleminderit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Nëse e
10 kuptova drejtë, juve thatë që keni pasur diskutime paraprake,
11 domethënë, nuk ka pasur ndonjë gjë të organizuar, ndonjë
12 shkëmbim të organizuar akoma, apo jo?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Neve nuk kemi organizuar ato
14 çka janë gjërat më të rëndësishme, domethënë, takimet ndërmjet
15 dëshmitarëve viktimë dhe le të themi, avokates mbrojtëse për
16 viktimat.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Fjala
18 për juve avokate e viktimave.

19 ZNJ. PUES: [Përkthim] Ju faleminderit, e nderuar
20 Gjykatëse.

21 Me të vërtetë është e drejtë, domethënë, që ne kemi
22 shkëmbime paraprake, kjo është fjala që u tha. Ky është një
23 dialog i vazhdueshëm, është një dialog i cili nuk ka
24 përfunduar ende dhe unë e kuptoj që kjo është një çështje
25 goxha komplekse dhe për pasojë nuk mund të komentoj më në këtë

1 pikë për këtë çështje.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Edhe
3 kjo në vetvete është një përgjigje.

4 Kalojmë me pikën 4 të rendit të ditës, prezantimi i
5 provave të dëshmitarëve. Atëherë sa i takon kësaj çështje,
6 ZPS-së i është kërkuar që të japë parashtrime sa i takon
7 marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të pranimit të
8 deklaratave të mëparshme. Pra, kemi një përmbledhje të
9 shkurtër të asaj çfarë kemi kërkuar. Ndërkohë që Mbrojtjes për
10 Viktimat i është kërkuar që të bëjë parashtrime, ndër të
11 tjera, për synimin e saj për të parashtruar prova dhe për të
12 thirrur dëshmitarë ekspert. Dhe të njëjtën pyetje ja kemi bërë
13 për Mbrojtjes sesa i takon deklaratave paraprake dhe
14 dëshmitarëve.

15 Nuk e di, në qoftë se, ndonjëra nga palët, në qoftë se
16 ju doni të bëni ndonjë deklaratë tjetër lidhur me këtë pikë të
17 rendit të ditës.

18 Prokuroria.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, jo nuk
20 është se kemi ndonjë gjë të madhe për të shtuar. Por thjeshtë
21 sa për publikun, do të doja të thosha që Prokuroria do të
22 thërrasë 14 plus 1 dëshmitarë dhe ne do të flasim rreth këtyre
23 dëshmitarëve në seancën me dyer të mbyllura që do të
24 organizojmë më pas.

25 Sa i takon një dëshmitari, pra, kemi një dëshmitar i cili

1 nuk është më i disponueshëm për të dhënë dëshmi në sallën e
2 gjyqit por, domethënë, ky është numri apo kjo është lista e
3 dëshmitarëve që neve planifikojmë që të thërrasim dhe të
4 pyesim në lidhje me këtë çështje.

5 Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

7 Mbrojtja për Viktimat.

8 ZNJ. PUES: [Përkthim] Nga ana ime do të duhej që të
9 përcaktohet plotësisht, sa i takon efekteve psikologjike që
10 kanë vuajtur disa prej viktimave. Megjithatë, një proces i
11 tillë vjen me një barrë të caktuar mbi viktimat dhe për këtë
12 arsye, kjo është një masë e cila duhet të mendohet me shumë
13 kujdes. Dhe po ashtu, ky proces duhet që të përcaktohet
14 plotësisht vetëm pasi të jenë takuar ballë për ballë apo pasi
15 të takohen fizikisht me këta persona sepse është aspekti
16 njerëzor, i cili do të duhet të merret shumë seriozisht
17 parasysh prej meje.

18 Megjithatë, do t'ju lë të dini, domethënë, sa më shpejt
19 të jetë e mundur, se cila është situata se cili është
20 rezultati, se pa diskutim që nuk dua që të shkaktoj vonesa.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Pra,
22 atëherë, faleminderit. Shumë mirë sa i takon vonesës ne nuk
23 duam që të krijohen vonesa.

24 Në qoftë se e kuptova drejtë, juve thatë që mund të
25 thërrasim një dëshmitar ekspert, por thatë, që kjo do të

1 përcaktohet pasi ju do të keni folur personalisht me viktimat.

2 Kështu thatë apo jo? Po.

3 Në rregull. E qartë.

4 Mbrojtja.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Ne nuk kemi konstatime të tjera
6 lidhur me këtë çështje. Pra, në qoftë se do të vij një ekspert
7 dëshmitarësh këtu, pa diskutim që ne do të kemi mundësinë që
8 ta marrim në pyetje.

9 Nuk kemi asgjë për të shtuar. Këto janë konstatimet e
10 vetme që kemi.

11 Faleminderit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Pra,
13 seanca është për të shtuar, jo për të përsëritur gjëra që i
14 kemi thënë më përpara. Ndonjëherë, ne theksojmë gjëra që janë
15 shumë të rëndësishme për ditën e sotme dhe gjëra të cilat janë
16 të rëndësishme për publikun, por parashtrimet tuaja janë shumë
17 të qarta dhe i kemi mbajtur shënim pikat e ngritura në këto
18 parashtrime.

19 Kalojmë tek pika numër 5, rendi i paraqitjes së
20 dëshmitarëve dhe çështje që kanë të bëjnë me marrjen në pyetje
21 të dëshmitarëve. Për ZPS-në, ne kemi marrë parashtrimet tuaja,
22 sa i takon paraqitjes së tyre, në qoftë se lista është
23 përfundimtare apo mënyrat e ndryshme sesi do të merren në
24 pyetje dëshmitarët.

25 Trupi Gjykses dëshiron të dijë, në qoftë se ZPS-ja mund

1 të japë informacion shtesë sa i takon rendit të paraqitjes së
2 dëshmitarëve përpara sesa të dihet se kur do të fillojë
3 procesi i gjykimit.

4 Fjala për ju zoti prokuror.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] ZPS-ja i qëndron parashtrimit
6 të saj edhe lidhur me këtë çështje. Ne do të kemi mundësi që
7 të përfundojmë me listën, në momentin kur është përfunduar,
8 kur është përcaktuar data e fillimit të gjykimit. Mbase mund
9 t'ju japim më shumë informacion gjatë sesionit *ex-parte* që do
10 të organizohet pas kësaj seance me dyer të hapura.

11 Për këtë pikë, Prokuroria nuk ka asgjë tjetër për të
12 shtuar, pra, sa i takon, pra, rendit të paraqitjes së
13 dëshmitarëve, nuk kemi asgjë tjetër për të shtuar në këtë
14 pikë.

15 Faleminderit.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
17 Mbrojtja për Viktimat a ka vëzhgime të tjera që do të
18 dëshirojë të bëjë në këtë pikë?

19 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit që më dhatë fjalën.
20 Jo, për këtë moment nuk kam pyetje të tjera.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
22 Atëherë, parashtrimet e pyetjeve me natyrë të ngjashme për
23 ZPS-në.

24 Fjala për ju Mbrojtje.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Pra, për derisa hetimet i kemi në

1 proces e sipër. Sa i takon rendit të dëshmitarëve do të doja
2 të thosha, në një pikë të caktuar kohe, do të kemi një ide që
3 do të shkojmë pak a shumë në të njëjtën linjë. Pra, ajo çfarë
4 po përpiqemi të bëjmë ne, është që pak a shumë t'i grupojmë
5 dëshmitarët dhe mendoj, se të gjitha palët do të ndjekin një
6 lloj rendi logjik me gjërat me të cilat po merremi dhe të mos
7 kalojmë nga një dëshmitar te një dëshmitar tërësisht tjetër.
8 Pra, mendojmë, që ne do të ndjekin një lloj rendi logjik të
9 gjithë dhe ne do të kthehemi dëshmitarëve tanë pra, për të
10 parë, do i pyesim ato domethënë, se kur janë të disponueshëm,
11 se çfarë kohe kanë në mënyrë që të mund të japin kontributet e
12 tyre në mënyrë të tillë që të formojmë grupime të tilla të
13 dëshmitarëve. Mendoj, që është logjike dhe bëhemi më efikas,
14 në qoftë se neve merremi me një çështje të caktuar, që
15 përfshin dëshmitar të caktuar që lidhen me atë çështje ta
16 përfundojmë këtë element dhe pastaj të vazhdojmë me një tjetër
17 çështje dhe me të tjerë dëshmitarë.

18 Pra, jam i sigurt që deri në fund të pushimit të
19 Gjykatës, ne do të kemi mundësi që të japim një lloj grupimi
20 lidhur me dëshmitarët.

21 Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,
23 do ishte e favorshme për neve që të bënit kësi lloj grupesh,
24 grupimesh apo blloqesh.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Mbrojtja, unë flas për Mbrojtjen.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Po
2 patjetër.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Domethënë, thjeshtë sa për ta
4 sqaruar. Unë flas për Mbrojtjen.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Po.
6 Unë kam një tjetër pyetje lidhur me këtë element. Trupi
7 Gjykes dëshiron të dijë, në qoftë se Mbrojtja mund të japë
8 pra, data të përditësuara të dëshmitarëve në rast se ndryshon
9 rendi i dëshmitarëve, me email për shembull.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Po patjetër, e nderuar Gjykatëse.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
12 Atëherë, neve kemi marrë parashtrimet sa i takon mënyrës së
13 parashtrimeve dhe mënyrës së marrjes në pyetje të dëshmitarëve
14 nga palët dhe nga Mbrojtja e Viktimave. Këto parashtrime i
15 kemi lexuar por, gjithsesi, në qoftë se keni ndonjë gjë tjetër
16 për të shtuar, ju lutem, merrni fjalën dhe thoni diçka.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jo për
18 momentin. Ne i qëndrojmë atyre çfarë kemi parashtruar dhe, në
19 qoftë se kemi pozicione të tjera do ju bëjmë me dije në
20 momentin e përshtatshëm.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Në
22 rregull.

23 Mbrojtja për Viktimën.

24 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit, për momentin nuk kam
25 asgjë tjetër për të shtuar.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

2 Mbrojtja.

3 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar, sa i takon kësaj
4 çështje të veçantë, ne e kemi bërë parashtrimin tonë dhe besoj
5 që kemi qenë të qartë lidhur me këtë temë. Dhe ne besojmë, se
6 Rregullorja në vetvete parashikon, se palët do të shkojnë
7 sipas një rendi të caktuar. Dhe ne besojmë se kjo është mënyra
8 sesi duhet që të realizohen seancat e tilla.

9 Ne besojmë që rregullat që kanë të bëjnë me këtë çështje
10 janë të detyrueshme, janë të domosdoshme, për të gjitha palët
11 edhe për Gjykatën po ashtu.

12 Faleminderit shumë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

14 Faleminderit. Kam dy pyetje për ju i nderuar mbrojtës. E para,
15 prokurori propozon paragrafi 35 deri në 37 të parashtrimeve të
16 veta, përdorimin e listës së dokumenteve që do të përdoren
17 gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve prej palëve.

18 Mendoj që kjo është në përputhje me propozimin që bëni
19 ju, në paragrafin 38, por për hir të qartësisë dhe konfirmimit
20 ua bëj këtë pyetje tani.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Është një prej atyre pikave të
22 rralla ku biem dakord me prokurorin dhe pikërisht, kjo është
23 pika.

24 Mendoj që është e dukshme që ta bëjmë kështu. Padyshim,
25 që ka gjëra që dalin në momentin e fundit por besoj që mund të

1 mbështetemi në ndihmën e njeri-tjetrit. Sidoqoftë, lista të
2 tilla të dokumenteve janë të dobishme për të gjithë që ndjekin
3 procesin për ju, për zyrtarët e Gjykatës dhe kështu me radhë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Ju
5 faleminderit - thotë gjykatësja. Kam edhe një pyetje.

6 A mund të më sqaroni mua dhe kolegëve të mi, kur thoni në
7 paragrafin 38, do t'ua lexoj për ta pasur më qartë. Thuhet se
8 "Pjesa më e madhe e dokumentacionit, sigurisht, do të jenë
9 provat që tashmë janë paraqitur".

10 Pyetja ime është: Për situata të -- a i keni parapa
11 situata të tilla, ku dokumentacioni nuk është paraqitur
12 paraprakisht. A janë këto dokumente që tashmë nuk janë nxjerrë
13 apo që nuk janë në sistemin e dokumentacionit elektronik *Legal*
14 *Workflow*?

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund të ketë dokumente të tillë
16 që mund të dalin në ndonjë fazë të procesit.

17 Padyshim që duam të kemi mundësinë që të dorëzojmë
18 materiale të tilla apo të nxjerrim materiale të tilla, në
19 qoftë se ato do të jenë të dobishme për dëshmitarin. Dhe në
20 raste të tilla propozojmë atë që e lexuat. Për rastet të tjera
21 besoj, që do ta kemi dokumentacionin e ngarkuar në *Legal*
22 *Workflow*.

23 Nuk e di nëse ju përgjigja pyetjes së suaj, e nderuar
24 Gjykatëse?

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Po. U

1 përgjigjët.

2 Me sa ju kuptova ky propozim që bëni në atë paragraf
3 është për raste të jashtëzakonshme, të veçanta jo për të
4 gjitha dokumentacionet.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Për ndonjë dokument të vetëm
6 apo për ndonjë gjë, për ndonjë pikë në lidhje me diçka, pra, e
7 kam fjalën që duhet të jemi fleksibil në rrethana të tilla.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Ju
9 kuptova. Ju faleminderit.

10 Tani, do të kalojmë në pikën 6, në lidhje me provat
11 shkresore apo jogojore sipas rregullit 102 dhe 104 të
12 Rregullores.

13 A keni ndonjë gjë për të shtuar lidhur me pranueshmërinë
14 e provave të tilla?

15 Z. DE MINICIS: Nuk kemi.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
17 Mbrojtësja e Viktimave.

18 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, nuk kemi asnjë gjë për të
19 shtuar.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
21 Mbrojtësi.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë tjetër për të
23 shtuar.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
25 Faleminderit, të gjitha palëve.

1 Tani, aspekti i tretë brenda kësaj pike është, në qoftë
2 se Trupi Gjykses duhet të marrë vendim në lidhje me
3 pranueshmërinë e provave në kohën e parashtrimit të tyre apo,
4 nëse kjo mund të shtyhet në nxjerrjen e vendimit.

5 E theksoj se ZPS-ja dhe Mbrojtësja e Viktimave dhe
6 Mbrojtësi kanë pikëpamje përputhëse në lidhje me këtë pikë.
7 Nuk e di nëse keni diçka tjetër për të shtuar?

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo. Ne favorizojmë që
9 pranueshmëria të bëhet në kohën e paraqitjes së provës dhe, në
10 qoftë se Trupit Gjykses do t'i duhet informacion tjetër në
11 lidhje me këtë vendim mund të marrim si shembull, procedurën
12 që është ndjekur në Tribunalin Penal për Ish-Jugosllavinë kur
13 provat shënoheshin për identifikim.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
15 Faleminderit.

16 Urdhëroni zonja përfaqësuese e viktimave.

17 ZNJ. PUES: [Përkthim] Ju faleminderit. Nuk kemi asnjë gjë
18 për të shtuar.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
20 Mbrojtësi.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi asgjë për të shtuar në
22 këtë pikë.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Tani,
24 do të kaloj në pikën 7, konstatim gjyqësor lidhur me faktet
25 sipas rregullit 175(2) të rregullores.

1 Pika e parë për çka interesohet Trupi Gjygues është, nëse
2 Mbrojtja dhe ZPS-ja kanë diskutuar mundësinë që t'i kërkojnë
3 njëra-tjetrës njoftim të tillë në lidhje me faktet e pranuar.

4 Urdhëroni z. Prokuror.

5 Z. DE MINICIS:[Përkthim] Ju faleminderit. U takuam dje me
6 mbrojtësin, me ekipin e mbrojtjes dhe bëmë një diskutim të
7 gjerë e gjatë lidhur me këtë aspekt të fakteve të pranuar.
8 Prokuroria duhet të paraqesë mocionin e vet dhe do ta njoftojë
9 paraprakisht Mbrojtjen për faktet, për të cilat do të kërkojë
10 konstatim gjyqësor.

11 Për momentin, nuk kemi gjë tjetër të planifikuar përveç
12 kësaj.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
14 Faleminderit.

15 Mbrojtësi.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse. Diskutimi në
17 lidhje me këtë pikë vazhdon dhe besoj, që do të arrijmë në
18 ndonjë marrëveshje.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
20 Faleminderit.

21 E dyta, i kërkuam Prokurorisë të bëjë parashtrime në
22 lidhje me këtë aspekt të fakteve të pranuar.

23 Për ju prokuror, kemi dy pyetje shtesë. E para, a mund të
24 parashikoni se për të cilat fakte do t'i duhet Trupit Gjygues
25 të bëjë konstatim gjyqësor. Dhe e dyta, në qoftë se do të

1 bëhet një kërkesë e tillë, a do të bëhet ajo brenda javëve që
2 vijnë?

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju faleminderit, e nderuar
4 Gjykatëse.

5 Në lidhje me faktet e pranuar nga palët, për të cilat do
6 të kërkojmë konstatim gjyqësor nga Trupi Gjyqësor, nuk e kemi
7 përfunduar definitivisht listën e fakteve. Po këto do të jenë
8 në lidhje me ekzistencën e konfliktit të armatosur në Kosovë
9 në atë kohë. Prokuroria mendon se është -- nuk shkon në dobi
10 të kohës së planifikimit të gjyqimit, në qoftë se do t'i
11 kërkohet Prokurorisë të paraqes prova në lidhje me ekzistencën
12 e konfliktit të armatosur, kur kjo tashmë është gjykuar në
13 shumë raste të tjera në gjykatat e tjera.

14 Dhe në lidhje me pyetjen e dytë, Prokuroria do të jetë në
15 gjendje të bëjë këtë mocion diku nga fundi i këtij muaji.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Tani për Mbrojtjen, a mund të na thoni se çfarë faktesh
19 të pranuar nga palët nga cilat procedura keni parasysh që t'i
20 paraqisni Trupit gjyqësor për konstatim gjyqësor. Dhe pyetja e
21 dytë, këtë kërkesë tuajën, a mund ta presim gjatë javëve që
22 vijojnë apo, nëse kjo nuk është e mundur atëherë, a mund të
23 na tregoni sepse nuk mund të bëni kërkesën e tillë brenda
24 javëve që vijnë?

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju faleminderit.

1 Ne duhet të përpiqemi të pajtohemi në lidhje me faktet e
2 pranuar nga të dy palët. Kjo do të jetë edhe mënyra më e
3 dobishme për të dyja palët. Ata e përpilojnë listën e vet pra,
4 Prokuroria përpilon listën e vet, nëse ne duhet ta përdorim
5 atë listë ose jo atë nuk mund tua them në këtë moment.

6 Për mendimin tim, mendoj pra, se diku nga fundi i muajit
7 do të jemi në gjendje të themi, në qoftë se kemi fakte të
8 gjykuara në gjykata të tjera për t'i pranuar. Por siç thashë
9 hapi i parë është që të shohim se çfarë ka parasysh ZPS-ja
10 dhe, në qoftë se ne mund të pajtohemi me ato fakte që ka
11 përzgjedhur ajo.

12 Shkurtimisht, do të përpiqemi që të arrijmë marrëveshje
13 lidhur me faktet e gjykuara në gjykata të tjera dhe të
14 pranuar nga palët. Në qoftë se arrijmë marrëveshje, atëherë,
15 mirë në qoftë se nuk arrijmë marrëveshje atëherë do t'i
16 gjykojmë ato aspekte apo pika për të cilat nuk është arrit
17 marrëveshje. Pra në qoftë se bëhet fjalë për fakte ligjore apo
18 fakte të gjykuara në gjykata të tjera.

19 Për t'ju dhënë afatet kohore mendoj, që diku nga fundi i
20 qershorit, ne do të jemi në gjendje të themi në qoftë se ato
21 fakte që ka paraqit Prokuroria duam të konsiderohen si fakte
22 të gjykuara në gjykata të tjera dhe të pranuar nga palët.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]

24 Do të bëj edhe disa pyetje tjera në lidhje me këtë
25 aspekt.

1 Pra, ju do të përpiqeni, që deri në fund të muajit të
2 propozoni një farë liste apo një përmbledhje të fakteve për të
3 cilat do t' i kërkonit Trupit Gjykses të bëjë konstatim
4 gjyqsor.

5 A ju kuptova drejtë?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Në qoftë se do ta bëjmë këtë dhe
7 nëse do ta bëjmë atëherë, kur?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
9 Pikërisht ashtu. Pra, në qoftë se do të përpiloni atë listën
10 atëherë do ta paraqisni atë.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Ne do të përpiqemi edhe një
12 herë nga fillimi po e them, të komunikojmë me ZPS-në për të
13 parë nëse lista e tyre -- nëse mund ta arrijmë marrëveshje me
14 listën në lidhje me faktet e paraqitura në listën e tyre.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Për
16 momentin e kam të qartë. Është mirë që t' i kemi parasysh
17 afatet sepse kjo na duhet për planifikimin e ecurisë së
18 mëtejshme të çështjes.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Ka jurisprudencë voluminoze
20 lidhur me faktet që mund të konsiderohen si fakte të gjykuara
21 paraprakisht në gjykata të tjera.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Më
23 vjen mirë që dëgjoj se jeni në gjendje ta bëni këtë, ta
24 zgjidhni këtë aspekt deri në fund të muajit.

25 Atëherë, nuk e di nëse Prokuroria ka diçka për të shtuar

1 në lidhje me këtë aspekt.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Pra,
4 këto ishin pikat që u paraqitën vendimin për caktimin e kësaj
5 e kësaj konference për përgatitjen e gjykimit. Ka edhe një
6 pikë tjetër që është ngritur nga Mbrojtja në parashtrimet e
7 saj me shkrim, përkatësisht nëse, dhe si kur anëtarët e ekipit
8 të Mbrojtjes apo të akuzuarit që marrin pjesë nëpërmjet
9 videolidhjes nëse ata mund të kenë biseda të privilegjuara me
10 klientin e tyre.

11 Ja jap fjalën z. Roche nga Zyra Administrative.

12 Z. ROCHE: [Përkthim] Kjo mund të organizohet në qoftë se,
13 p.sh., Von Bone do të ketë një bisedë të mbrojtur apo të
14 privilegjuar me klientin e tij, atëherë, kjo mund të
15 organizohet me anë të telefonit. Kemi një linjë të mbrojtur të
16 telefonit, e cila është e Gjykatës. Në qoftë se ju duhen
17 hollësira të tjera mund t'ua jap por në pikat të shkurtra, kjo
18 mund të mundësohet.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Ju
20 faleminderit. Fjalën dua t'ia jap mbrojtësit, ai mund të ketë
21 edhe pyetje shtesë për ju.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse.
23 Ndonjëherë, ndodh që jam me klientin tim diskutoj gjëra gjatë
24 pushimit p.sh., në qoftë se pjesëmarrësit e tjerë duan që të
25 jenë aty, por nuk janë të pranishëm fizikisht, dua që të di

1 nëse ekziston mundësia që ata të mund të lidhen në atë
2 diskutim me videolidhje.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Pra,
4 ju e keni fjalën për diskutime që bëhen në grup prej tre apo
5 katër personash, pra, tre anëtarët e ekipit tuaj dhe z.
6 Mustafa. Pra, kjo është një farë lloj takimi nëpërmjet
7 aplikacionit Zoom.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo nuk është takim në Zoom p.sh.,
9 të themi, unë jam me z. Mustafa këtu kurse mbrojtësi,
10 bashkëmbrojtësi është diku jashtë por duhet të marrë pjesë në
11 atë mbledhje. Atëherë, si mund të lidhemi ne të dy me
12 mbrojtësin. Pra është një aspekt praktik.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
14 urdhëroni z. Roche.

15 Z. ROCHE: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar Gjykatës.

16 Jashtë sallës së gjyqit apo brenda kësaj salle gjyqi nuk
17 ka mekanizëm për të pasur një thirrje me anë të Zoomit apo të
18 videoconferencës. Ne e kemi parashikuar që një bisedë e tillë
19 do të zhvillohet nëpërmjet telefonit të mbrojtur, linjës së
20 mbrojtur dhe për atë e përmenda atë.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Pra, është përmjet telefonit që
22 do të marrë pjesë dikush tjetër në mbledhje, në qoftë se ky do
23 të jetë përkthyesi apo ndonjë bashkëmbrojtës në qoftë se unë
24 nuk jam aty.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Pra,

1 në qoftë se këto biseda do të zhvillohen me anë të telefonit
2 të mbrojtur atëherë, si do të bëhet kjo? Në njërin anë është
3 një person, në anën tjetër është personi tjetër me
4 përkthyesin.

5 Z. ROCHE: [Përkthim] Në qoftë se ka nevojë për përkthim
6 atëherë, ne do ta sigurojmë atë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] Ju
8 faleminderit.

9 Në këtë moment do t'ju kërkoj palëve dhe përfaqësueses së
10 viktimave në qoftë se ka ndonjë pikë tjetër për të ngritur.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, në këtë
12 moment s'kemi asgjë tjetër për të ngritur.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
14 Mbrojtësja e Viktimave.

15 ZNJ. PUES: [Përkthim] Shumë shkurt. Një masë praktike në
16 lidhje me procedurën gjyqësore.

17 Kemi folur për datën e mundshme të fillimit, kjo është
18 ndoshta një çështje shumë e thjeshtë, po a ka ndonjë
19 indikacion se, çfarë ditësh të javës do të zhvillohen seancat
20 gjyqësore sepse kjo do të na ndihmonte në planifikim.

21 Pra, çfarë mund të na thoni, se në cilat ditë të javës do
22 të zhvillohen seancat në qoftë se e keni këtë informacion?

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim] E
24 morëm shënim kërkesën tuaj dhe do të përpiqem të bëjmë një
25 planifikim apo një kalendar sa më shpejtë që të jetë e mundur,

1 por këto gjëra i kemi diskutuar tashmë dhe janë me rëndësi për
2 të gjithë personat e pranishëm në sallën e gjyqit dhe jashtë
3 sallës së gjyqit për organizuar punët e tyre. Dhe ky
4 informacion do të jetë i dobishëm për ju.

5 Planifikimi është një nga çështjet kryesore me të cilat
6 do të merremi. Do t'ju njoftojmë për këtë.

7 I nderuar Mbrojtës, keni diçka?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo asgjë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
10 Faleminderit.

11 Palët dhe Mbrojtësja e Viktimave mund t'i paraqesin me
12 shkrim Trupit Gjykses dhe ne ende s'e kemi marrë vendimin se
13 kur do të fillojmë por desha të them si vërejtje e
14 përgjithshme se, në qoftë se mendoni se nevojitet edhe një
15 konferencë tjetër për përgatitjen në gjykim mund të na thoni.

16 Dhe së fundi, ju njoftoj se përpara sesa të hapet apo të
17 fillojë gjykimi ne, si Trup Gjykses, kemi ndërmend vendimet e
18 mëposhtme: sigurisht, e para vendimi për datën e përafërt se
19 kur do të fillojë gjykimi; vendimi i dytë është vendim që
20 përcakton të drejtat e viktimave që marrin pjesë në procedura;
21 dhe, do të nxjerrim dhe një vendim në lidhje me zhvillimin e
22 procesit gjyqësor. Dhe propozojmë nga ana jonë që Prokuroria
23 dhe Mbrojtja të bëjnë një parashtrim të përbashkët në lidhje
24 me faktet, tashmë të gjykuara, në gjykime të tjera.

25 Me kaq përfundon seanca publike e ditës së sotme.

1 I falënderoj palët, Mbrojtësen e Viktimave dhe Zyrën
2 Administrative për pjesëmarrjen. Dhe dëshiroj, gjithashtu, të
3 falënderoj përkthyesit, stenografin, teknikët audiovizual,
4 personelin e sigurisë, për ndihmën që na kanë dhënë.

5 Do të mblidhemi përsëri në seancë të mbyllur me
6 Prokurorinë dhe disa nga njësitë e Zyrës Administrative.

7 Do të konsultohem shkurtimisht me kolegët e mi tani,
8 prandaj do ta mbyll mikrofonin.[Mikrofoni nuk është aktiv]

9 [Anëtarët e Trupit Gjykes këshillohen midis tyre]

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
11 Faleminderit për durimin.

12 Vendosëm që do të mblidhemi përsëri sot në seancë të
13 mbyllur me Zyrën e Prokurorisë së Specializuar dhe me njësitë
14 e Zyrës Administrative në orën 14:30 dhe shpresojmë që të
15 gjithë janë të disponueshëm në atë kohë.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, mund të bëj
17 një pyetje?

18 Ne nuk ka nevojë të jemi të pranishëm më vonë, gjatë
19 seancës së më vonshme apo jo? Dhe, po kështu edhe nesër prania
20 jonë nuk është nuk kërkohet në seancën e nesërme?

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA:[Përkthim]
22 Faleminderit, i nderuar Mbrojtës. Është një pyetje e
23 rëndësishme dhe shumë e mirë.

24 Po, nesër nuk është e nevojshme të jeni i pranishëm në
25 seancë sepse e përfundam seancën e hapur të kësaj konference

1 për përgatitjen e gjykimit sot dhe nesër kemi planifikuar që
2 nesër të mblidhemi nëse do të jetë e nevojshme. Kemi punuar të
3 gjithë shumë dhe në mënyrë shumë efikase deri tani.

4 Seanca mbyllet.

5 --- Konferenca përgatitore për gjykim përfundon
6 në orën 10.58

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22